

## Procesverbal (ekstrakt)

Nga mbledhja e I-rë/2018 e Komitetit për Politikë e Financa e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 21.02.2018, duke filluar në ora 9.00, me këtë :

### *R e n d   d i t e*

1. Shqyrtimi i materialeve-përgatitjeve për seancën e III-të KK-së..., dhe
2. Eventuale...

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe i këtij Komiteti z.Betim Merdiu, duke përshëndetur të pranishmit...me kërkesën nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse nuk ka, njëzëri, miratohet rendi i ditës.

### **Pika e I (parë) e rendit të ditës**

Në kuadër të pikës së I-rë-përgatitjeve për seancën e III-të të Kuvendit,vazhdojmë me radhë...

**I.1.** Për Procesverbalin e seancës nuk kemi çka të bisedojmë, nga se ai miratohet nga Kuvendi.

**I.2.**Tani kalojmë në pikën e 2-të seancës reth P/Vendimit lidhur me themelimin e KKSBBashkësi i cili merret me çështjet e sigurisë të ne dhe paraqet obligim të funksionimit në çdo komunë dhe, siç e keni edhe në material, kryesisht, përbëhet nga anëtarë-sipas funksioneve që janë anëtarët e tijë, kurse duhet të plotësohen vendet e paplotësuara në P/Vendim, nga radhët e komuniteteve...

z.Zinaida Elmazi- Ky Këshill i Sigurisë është mjaft i rëndësishëm, pasi se, në të kaluarën, kemi pasur raste si vjedhjeve etj. Që kanë ndikuar në aspektin e sigurisë, me të cilat çështje është marr ai Këshill, si dhe prap ka çështje të rëndësishme me të cilat duhet të merret. Prandaj, në vendet e papërfshira në P/Vendim mendoj duhet të përfaqësohen femërat në emër të komuniteteve tona, për të ardhur, sado-kudo, në shprehje edhe barazia adekuate gjinore.

Kryesuesi- Kjo është e dëshirueshme dhe në rregull dhe ka mundësi të bëhet me vendet e papërfshira në P/Vendim, nëse ashtu vendoset edhe në seancë të Kuvendit, që shumë varet nga propozimet e subjekteve politike dhe vetë delegatët?

z.Arijeta Skeraj- Të kalohet me P/Vendimin në Kuvend dhe plotësohen vendet e papërfshira nga komuniteti.

z.Artan Loshaj- Ky Komitet apo Këshill përbëhet sipas përfaqësimeve adekuate zyrtare, kurse nga radhët e komuniteteve plotësimi bëhet nga ana e Kuvendit. Megjithkëtë, do të ishte mirë që propozimet të bëhen edhe këtu e jo drejtpërdrejtë në Kuvend, pasi se komitetet e kanë për detyrë dhe obligim t'a lehtësojnë punën, për në Kuvend.

z.Selman Osmani- Mendoj se propozimi i z.Artan L. është në rregull dhe ne mund të propozojmë emrat dhe unë, në emër të komunitetit Goran, propozoj z.Zarifa Alija, nga JGP-ja.

z.Zinaida Elmazi- Unë nuk jam sot për propozime këtu, por këtë çështje, pas konsultimeve paraprake, t'ia lëm Kuvendit, ku edhe miratohet P/Vendimi.

z.Arijeta Skeraj- Më mirë që propozimet të konsultohen e propozohen në Kuvend.

z.Zinaida Elmazi- Te komuniteti Goran kemi 3 opcione-subjekte politike(JGP,GIG,PG) e nevoitet një kandidat/e?

z.Selman Osmani- E pranoj këtë që theksoi kolegja, por mos të ngjan që të ndahemi e ngarkohemi partiakisht në Kuvend, sepse ju psh. jeni nga partia Boshnjake ("Vakat")?

z.Shaban Shabani (kryetar i Komunës)- Ky P/Vendim është i paraparë, decidivisht, sipas UA i cili rregullon përbërjen dhe funksionimin e KKSBB-së dhe s'ka shumë mundësi manevrimi reth përfaqësimit të të gjithëve, që do të kishin nevojë dhe dëshira. Pranda, për t'u përfshiri, sa më shumë, edhe barazia gjinore, mund të jepen propozime, për të cilat, prap, vendos Kuvendi. Por, këtu, do t'a kemi edhe mbledhjen e Komitetit për Komunitete ku mund të dalin edhe aty propozime-për në Kuvend, kurse personat e propozuar me emra në P/Vendim janë sipas funksioneve dhe asaj që parashef UA. Kjo vlen edhe për subjektet shqiptare që duhet të dalin me një emër-kandidat/e.

z.Lindita Piraj (ZÇGJ)- Edhe unë, pajtohem që të avancohet përfaqësimi i femërave në organet e parapra komunale, si KKSBB-ja tani.

Kryesuesi- Pra, të përcaktohem, që të vendos Kuvendi...?(Miratohet ky qëndrim i Komitetit).

**I.3.** Vazhdojmë me punën dhe tani e kemi P/Vendimin lidhur me Kërkesën e KEDS-it për vendosjen e 2 trafo-stacioneve elektrike në fshatin Brod...

Kryetari- Personalisht, mendoj se është për t'u përkrahur, pasi se është në të mirë të komunitetit atje, për furnizim harmonik me energji elektrike, kur dihet se rrjeti elektrikë te ne është i vjetër. Mendoj se DUrbanizmit është bazuar në dokumentet zyrtare reth pronës shoqërore e që duhet të vendos Kuvendi-pa kompenzim dhe me lidhje të Kontratës adekuate me Komunën, siç parashihet edhe në P/Vendim...

z.Artan Loshaj- Lidhur me këtë, unë kam biseduar me drejtorin e DU nga i cili kam marr sqarime se me Kontratë parashihet vetëm pagesa e taksës vjetore.

z.Zinaida Elmazi- A ka pengesa për këtë vendosje të trafove nga qytetarët?

Kryetari- Sipas njoftimit të drejtorit të DU, pengesa të tilla nuk ka.

Kryesuesi- Në rregull, mendoj se duhet t'a përcjellim P/Vendimin në Kuvend...?(Miratohet ky qëndrim i Komitetit).

### **Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës "eventuale"...**

Te pika e III-të "eventuale", urdhëroni, nëse keni diçka...?

z.Zinaida Elmazi- Të ju njoftoj se në Ditën e Pavarësisë-më 17 shkurt, në komunën tonë, përkatësisht në shoqatën "Gekak" ka qenë ambasadorja turke Kiliç dhe ish-kryeministri turk Davutoglu ku ishin edhe veprimtarët e koalicionit tonë "Vakat" dhe zyrtarë komunal. Aty u bisedu reth bashkëpunimit të komunës sonë me institucionet turke, përfshiri këtu edhe faktin se komuna e jonë ka zyrtarizuar vëllazërimin me komunën e Sapanxhës, por edhe me ndonjë tjetër komunë, nga se Turqia është e gatshme t'i thellon kontaktet dhe ndihëmon komunën tone, sidomos me investime.

Kryetari- Nga parafolësja z.Zinaida E. u përmend vizita e zyrtarëve turk në kuadër të shënimit të 10-vjetorit të Ditës së Pavarësisë në komunën tonë ku ne, si zyrtarë komunal, i kemi paraqitur qëndrimet tona lidhur me kontaktet e deritashme dhe nevojën e bashkëpunimit në të ardhmen. Pos zyrtarëve që u përmendën, prezent kanë qenë edhe përfaqësuesit e shoqatës qeveritare turke "Tika" të cilët u interesuan për investime reth trashigimisë kulturore, siç është "Tyrbja e Pllavës", ngritja e lapidarëve në fshatin Zlipotok dhe Dragash kushtuar të rënëve tonë në betejën e Çanakalashë. Për këto aktivitete, shpresojë se do të njoftohemi në vazhdimësi.

z.Zinaida Elmazi- Po, kjo vizitë ishte me ndërmjetësimin e OJQ "Gekak" e ku kanë qenë prezent edhe kryetari i komunës sonë z.Shaban Shabani.

Kryetari- Me këtë rast po theksoj se unë nga shoqata qeveritare turke "Tika" kam kërkuar investime në sallën tone të Kuvendit Komunal, apo në QKMF-në "Adem Berisha" në Dragash, kurse sa i përket vazhimit të kontakteve me komunën e binjakëzuar të Sapanxhës, po theksoj se atje, si duket, shumë ka ndryshuar me mbajtjen e zgjedhjeve të reja ku kanë fituar subjekte tjera politik e që nevojitet përtrirë kontaktet.

z.Zinaida Elmazi- Mendoj se kontaktet me Turqinë duhet vazhduar në të gjitha fushat, sidomos kur dihet se atje kemi shumë bashkatdhetarë tanë që kanë migruar më herët, sidomos në qytetet e Bursës ku ka mjaft nga komuna e jonë.

z.Arijeta Skeraj- Më intereson të di se deri ku kanë arritur kontaktet me komunën e binjakëzuar të Sapanxhës, apo fajtor janë vetëm zgjedhjet?

Kryetari- Kontaktet kanë vazhduar pas aktit të binjakëzimit dhe ka ngelur që ata të bëjnë një vizitë këthyese në komunën tone e cila ende nuk ka ngjarë e që duhet të interesohemi?

Kryesuesi- Nëse nuk kemi edhe diçka kalojmë të kërkesët e adresuara Komitetit tone, por edhe Kuvendit, shkojmë me radhë... I. Fillimisht, kemi Kërkesën e z.Hismet Qafleshi nga Bellobradi për shërimin e bijës së tij Gentianës jasht-vendit në Francë, si rast i njohur në opinion dhe i përkrahur në forma të ndryshme e që duhet të kyçet edhe Komuna me jete buxhetore-subvencione.

Kryetari- Po, rasti tash më është i njohur dhe në aktivitete janë kyçur shoqata të ndryshe humanitare dhe njerëz të vullnetit të mirë e që kontributin duhet të jep edhe Komuna, edhe pse kërkesat për shërim janë të mëdha, por ky është rast i ngritur veçanarisht e specifik i shërimit jasht vendit për diagnozën e anemisë hipoplastike.

z.Zinaida Elmazi- A ka mundësi që edhe ne-delegatët e Kuvendit, si dhe shërbyesit civil të ndajmë mjete nga të ardhurat tona, për raste të këtilla?

Kryesuesi- Unë mendoj e s'di se a pajtoheni edhe ju që kërkesat e karakterit shëndetësor t'i adresohen Komisionit për Shëndetësi, për të vendosur në bashkëpunim me kryetarin i cili, po ashtu, ka mjaft kërkesa të kësaj natyre? (Miratohet ky qëndrim i Komitetit).

Tani kalojmë në kërkesat e institucioneve...ku kemi: Kërkesa e KF "Opoja", KF "Aroma", FK "Dragashi" dhe OK Kryqit të Kuq dhe një kërkesë për xhirimin e spotit muzikor nga këngëtari opojar - Masar Sinani.

Kryetari- Në rregull, angazhohem që t'i kanalizojmë kërkesat mbi 1 mijë euro e ato janë psh. të KF "Opoja", që ka më shumë nevojë për gara të rangut...?

Kryesuesi- Kalojmë me radhë-vendoset për 3 mijë euro për KF Opoja", pastaj rasti karakteristikë i Gentiana Qafleshit- vendoset për 2 mijë euro, KF "Aroma", pastaj KF "Dragashi"-vendoset për nga 500,00 euro, siç vendoset edhe për OK të Kryqit të Kuq dhe këngëtarin Masar Sinani-nga 500,00 euro, pra në tërësi të ndahen 7 mijë euro, nga pozicioni i subvencioneve. Ndërkaq, kërkesat tjera të adresuara kryetarit, të orjentoohen në komisionet përkatëse komunale-sidomos ato për shëndetësi, në Komisionin për Shëndetësi. (miratohet ky Vendim-qëndrim i Komitetit).

Nëse nuk kemi edhe diçka tjetër, me këtë, përfundojmë mbledhjen e sotme të Komitetit tonë.

Procesmbajtësi:

*Azbi Halili*

**Komiteti për Politikë e Financa i KK-së**

**Kryesuesi**

***Betim Merdiu***



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

**LISTA**  
**E KOMITETIT PËR POLITIKË E FINANCA-DRAGASH**  
**KOMITETA ZA POLITIKU I FINANSIJE-DRAGAŠ**

Nr Br	Emri dhe mbiemri Ime i prezime	Subjekti politik Politički subjekat	Nënshkrimi Potpis
1	Betim Merdiu, kryes.-pred.	PDK	<i>[Signature]</i>
2	Artan Loshaj	PDK	<i>[Signature]</i>
3	Xhemile Misinaj	PDK	<i>[Signature]</i>
4	Arjeta Skeraj	LDK	<i>[Signature]</i>
5	Aida Misini-Halimi	LDK	<i>[Signature]</i>
6	Zinaida Elmazi	Vakat	<i>[Signature]</i>
7	Selman Osmani	JGP	<i>[Signature]</i>

Mysafirët – Gosti :

1. *[Signature]* - Osma
2. *[Signature]*
3. *[Signature]*
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

Dt. 21.02.2018

Kryesuesi – Predsedavajci :  
**Betim Merdiu**

*[Signature]*  
*[Stamp]*